



Presidenti i BSPSH Gëzim Kalaja mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Konfederata turke “MEMURSEN” me president z. Ali Yalcin. Në këtë konferencë madhështore morën pjesë përfaqësuesit e 81 vendeve dhe personalitete të larta të Turqisë. Presidenti i BSPSH z. Kalaja ishte zgjedhur nga Konfederata “MEMURSEN” për të prezantuar në një nga panelet situatën dhe gjendjen në Ballkan dhe kontributin që po japin sindikatat, për përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike të punonjësve. Fjalimi i Presidentit të BSPSH u duartrokkit nga të gjithë pjesëmarrësit të cilët në shenjë nderimi dhe respekti u ngritën në këmbë. Ndërsa në pritjen zyrtare në rezidencë me Kryeministrin e Turqisë, z. Gëzim Kalaja u përzgjedh në protokollin zyrtar. Vlen të theksohet se BSPSH-së në të gjitha ditët e simpoziumit iu dha një vend shumë i rëndësishëm. Simpoziumi përfundoi me nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis sindikatave dhe me një “deklaratë solidariteti” me sindikatat e botës islame. Presidenti i konfederatës turke “MEMURSEN” z. Ali Yalcin u shpreh se shumë shpejt do të prezantojë shembullin e z. Kalaja për lëvizjen sindikaliste në Shqipëri, luftën për liri dhe demokraci, edhe tek anëtarët e konfederatës që ai drejton. Presidentit Kalaja iu akordua dhe “çertifikata e mirënjohjes”.







